



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS  
OSNOVNI SUD U MITROVICU - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.102 /2012

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS** si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi , në çeshtjen juridike të paditësit: nga , kundër të paditurës Komuna e , të cilën e përfaqëson Avokati Publik Komunal , baza e kontestit: vërtetim pronësie, pas mbajtjes së scancës kryesore të datës: 06.02.2014 në prani të palvë ndërgjyqëse, me datë: 12.02.2014 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **VËRTETOHET** se paditësi eshtë pronar në bazë të drejtës së ndërtimit; i pjesëve të paluajtshmërive Nr. me sipërfaqe prej 99 m<sup>2</sup> dhe pjesës së ngastrës nr me sipërfaqe prej 6 m<sup>2</sup>, në total 105 m<sup>2</sup> e cila evdidentohet në emër të Komunës së
- II. **OBLIGOHET** e paditura që t'ia njoh palës paditëse këtë të drejtë dhe t'ia mundësoj të njëjtës që këtë të drejtë ta rexhistrojë në rexhistrat kadastral, në të kundërtën ky aktgjykim do të përmbarohet në mënyrë të dhunshme
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

**A r s y e t i m**

Paditësi me anë të padisë së parashtruar në gjykatë me datë: 15.05.2012 me datë: 05.11.2009 ka parashtruar në gjykatë padi për vërtetim pronësie i pjesës së sipërfaqes prej 35 m<sup>2</sup> sipas ngastrës .

E paditura përmes përfaqësuesit të të paditurës deklaroi se propozon që vendimi të jetë në bazë të rezultatit të provave.

Gjykata sipas propozimit të palës paditëse ka dal në vend bashkë me ekspertin e gjeodezisë.



*Lejfalet me datë  
M. A. Balla*

Gjykata ka mbajtur seancën kryesore në këtë çështje me datë: 06.02.2014, ku në këtë seancë paditësi deklaroi mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke precizuar të njëjtën sipas ekspertizës gjeodete ku tani kërkoi që gjykata pas administrimit të provave të vërtetoi se pronar në bazë të së ndërtimit në tokën e huaz, i sipërsfares prej 105 m<sup>2</sup>, pjesë e ngastrës kadastrale (99 m<sup>2</sup>) dhe ngastrës (6m<sup>2</sup>) të cilat evidentohen në emër të të paditurës, duke propozuar dëshmitarët; dhe ndërsa hjeku dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve, të propozuar në seancën e datës: 17.12.2013.

Përfaqësuesi i të paditurës deklaroi se mbetet në tërësi në kërkesën e epilogut të procedimit në bazë të rezultatit të provave, ndërsa nuk e kundërshtoi dëgjimin e dëshmitarëve.

Kundër të paditurës lirim prone dhe pagesën e borxhit kundër të paditurit:

Paditësja dy herë me anë të parashtresës ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, njëherë me datën: 20.03.2009 dhe herën e dytë me datë: 05.09.2009.

Në fjalën përfundimtare paditësi deklaroi se mbetet në tërësi si në deklarimin e dhënën në seancën e të njëjtës datë, pra seancën kryesore.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i të paditurës deklaroi në tërësi Si në fjalën hyrëse të seancës së sotme.

Në seancë kryesore u dëgjuan këta dëshmitarë:  
dhe

Nga provat materiale gjykata administroi këto prova: ekspertiza gjeodete e datës: 08.01.2014, procesverbal i daljes në vend i dt.08.01.2014, skicat e terenit të bashkangitura ekspertizës gjeodete të datës: 08.01.2014, kontrata mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtshme e dt.04.09.2005, certifikatës me numër të njësisë , ekstrakti nga fletëposedimi i datës: 27.02.2002, kopja e planit e dt.27.02.2002.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së, dhe pas bindjes së lirë erdhë në këto përfundime:

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se paditësi me familjen e tij e kanë pas në posedim dhe shfrytëzim pjesët e parcelave kontestuese pasi një gjë e tillë vërtetohet në bazë të deklaratave të dëshmitarëve: ku dëshmitari ndër të tjera ka deklaruar: "Unë në atë vend banoi që 35 vite, shtëpia ku une banoi ka qenë e gjyshes, mirëpo psi që ka vdekur gjyshja dhe daja shtëpia më ka mbetur mua, e kamë fqinjë e dijë se ka banuar para luftës e ka pasur shtëpinë e ndërtuar në atë pjesë, e as para luftë e as pas luftës nuk e ka askush në atë shtëpi", dëshmitari tjetër në deklaratën e tij theksón: "ka ardhur me familje ka rrëth 55 vite, e dijë që shtëpia është ndërtuar para luftës, unë nuk e dij që dikush e ka penguar në shfrytëzimin e të njëjtës para apo pas luftës", Dëshmitari në deklaratën e tij. theksói: "Truallinpëllacin ku tani banon e ka blerë babi i tij prej rrëth 50 vite më parë, më vonë e ka ndërtuar shtëpinë pjesa e parë e truallit aty ka qenë një urë, mirëpo para luftës në atë pjesë e ka ndërtuar objektin tjetër, deri më sot e atij askush nuk ka penguar në shfrytëzimin e të njëjtës".

Gjykata me rastin e vlerësimit të kredibilitetit të këtyre dëshmitarëve vendosi që dëshmive të tyre tua fal bësimin e plotë, pasi të njëjtat ishin reale, dhe objektive.

Për gjykatën nuk është kontestuese se e paditura është pronare e pronës në fjalë, e cila vërtetohet nga certifikata e pronësisë,

I padituri të drejtën e tij e mbështet në nenin 24 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, që slet mbi të drejtën e ndërtimit si mënyrë e fitimit të pronësisë.

Sipas Ligjit Mbi Marëdhniet Themelore Juridike-Pronësore nen 24 thuhet citoi: "Personi që mund të jetë bartës i së drejtës së pronësisë, e që ndërton ndërtesën ose godinën tjetër (objekti ndërtimor) në tokën mbi të cilën tjetri ka të drejtën e pronësisë (ndërtuesi), fiton të drejtën e pronësisë edhe mbi tokën në të cilën është ndërtuar objekti ndërtimor, si dhe mbi tokën që është e domosdoshme për përdorimin e rregullt të këtij objekti ndërtimor, po që se nuk ka ditur, as që ka mundur të dinte se po ndërton në tokën e huaj, kurse pronari i tokës ka pasur dijeni për ndërtimin dhe nuk ka kundërshtuar menjëherë.

Gjykata në rastin konkret do ta aplikon Ligjin e Mëhershëm pra Ligjin Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, meqenëse baza juridikë është krijuar në atë kohë, andaj aplikohet ai Ligi.

E Paditura ka qenë e njoftuar, apo ka mundur të jetë se paditësi- ka ndërtuar në pronën e të paditurës.

E paditura asnjëher me kurrfarë veprimi nuk ka kundërshtuar ndërtimin e bërë nga paditësi në atë pjesë, edhe pse në bazë të daljes në vend ka konstatuar se muret e jashtme në të cilat është ndërtuar objekti në atë pjesë, vërtetohet se ndërtimi është bërë para lufte, krejt kjo në bazë të mureve të ndërtuara.

Duke marrë për bazë faktin se paditësi në atë pjesë banon rrëth 50 vite, i cili fakt vërtetohet në bazë të deklaratave të dëshmitarëve të cituara më lartë, vërteton edhe mirëbesimin e paditësit me rastin e ndërtimit.

Gjykata konform nenit 450 të LPK-së vendosi si në dispozitiv sa i përket shpenzimeve të procedurës, pasi që asnjëra palë nuk i kërkuau shpenzimet procedurale.

Aktgjykimi bazohet në nenin 143, par.1 të LPK .

### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË


C.nr.102/2012 të dt.12.02.2014

REPUBLICA KOSOVA REPUBLIKA KOSOVA

ENDIMI ËSHTË I PLOT FUGJISHMËR  
ODËUKA JE PRÌVATISAZNA  
GJYKATA THEMELORE TULONVNI SUD  
MITROVICË - MITROVICË

Më  
Ditë:

10.03.2014



**UDHËZIM MBÌ MJETIN JURIDIK :** Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, brenda afatit 15 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.